


MANIFESTI I TË DHËNAVE PËR LIDERËT

MUNDËSITË MË TË MIRA
TË ORGANIZATËS SUAJ PËR
RRITJE ORGANIKE
GJENDEN TEK TË DHËNAT

TË DHËNAT OFROJNË MUNDËSI TË SHUMTA TË PASHFRYTËZUARA PËR TË KRIJUAR AVANTAZH KONKURRUES, TË ARDHURA DHE VENDE TË REJA PUNE; PËRMIRSOJNË KUJDESIN SHËNDETËSOR, SIGURINË E TË GJITHËVE DHE, NDËR TË TJERA, PËRMIRSOJNË KONDITAT NJERËZORE.

ORGANIZATAT JANË ENDE LARG NGA TË QENIT TË BAZUARA TEK TË DHËNAT.

SHUMICA E KOMPANIVE:



1. NUK KANË DIJENI TË PLOTË RRETH TË DHËNAVE QË ZOTOJNË APO ÇFARË TË DHËNASH JANË MË TË RËNDËSISHME
2. NGATËRROJNË "TË DHËNAT" ME "TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT" OSE DIXHITALIZIMIN, QË ÇON NË MENAXHIMIN E DOBËT TË TË DYJAVE
3. NUK KANË NDONJË VIZION APO STRATEGJI QË SHPALOS SE SI TË DHËNAT KONTRIBUOJNË NË BIZNESIN E TYRE
4. NËNVLERËSOJNË PËRPJEKJEN E DOMOSDOSHME PËR MENAXHIMIN E TË DHËNAVE DHE NUK KANË STRUKTURËN E PËRSHTATSHME ORGANIZATIVE PËR NJË PËRPJEKJE TË ATILLË

SHUMË KOMPANI KANË PATUR SUKSES NË ANALITIKË, ADMINISTRIM, CILËSI E PËRPJEKJE TË TJERA, POR NË SHKALLË TË VOGËL. MEGJITHATË, ENDE NUK KEMI HASUR NDONJË KOMPANI ME TRANSFORMIM RRËNJËSOR, TË QENDRUESHËM E TË PËRGJITHSHËM, QË NUK UDHËHIQET NGA NJË **LIDERSHIP I ANGAZHUAR** APO PA PËRFSHIRJEN E KUJTDONË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZATËS.

... DHE JEMI TË VETËDIJSHËM SE SA I VËSHTIRË ËSHTË ZBËRTHIMI I POTENCIALIT TË TË DHËNAVE NË ÇDO NIVEL ORGANIZATIV.

— PRANDAJ, NXISIM CILINDO TË UDHËHEQË NDRYSHIMIN —

ANËTARË TË BORDEVE, DREJTORË E LIDERË EKZEKUTIVË: SFIDONI MENDIMET E VJETRUARA MBI TË DHËNAT

Trajtojini të dhënat jo si detaje teknologjike informacioni të shpërndara nëpër sistemet tuaja kompjuterike, por si **burim të pakufizuar të mundësive të reja**. Kuptoni se potenciali i të dhënave nuk është vetëm për specialistët, si analistët e të dhënave, por për të gjithë, si dhe **një mënyrë për kompaninë tuaj të dallohet vërtet dukshëm** nga konkurrentët. Trajtojini të dhënat në mënyrë të tillë që të lini pas **një trashëgimi të qëndrueshme**. Përfytyrojini të dhënat si një hyrje aktive në bilanc.

Lidershipi u detyron aksionerëve dhe anëtarëve të tjerë organizativë një vizion për të dhënat. Hapi i parë ka të bëjë me këto pika:

1. Kujdesuni për të dhënat duke u përqendruar tek cilësia e të dhënave tuaja më të rëndësishme.
2. Shqyrtoni mënyrat e ndryshme se si të shfrytëzoni të dhënat për të fituar një avantazh konkurrues.
3. Parashtroni një sistem të përshtatshëm administrimi të të dhënave duke marrë parasysh rigorozitetin e tyre.

PËR KËDO QË KA NEVOJË PËR TË DHËNA NË PUNËN E VET: NXITNI NDRYSHIMIN

Mundësitë janë të shumta, prandaj zgjidhni dy-tre fusha që ju interesojnë, si përsëmbull përmirësimi i cilësisë së të dhënave, zbulimi i një metode më të thellë analitike, zhvillimi i një metrike të re, një ide mbi vlerësimin monetar të të dhënave apo shfrytëzimin e të dhënave për të bashkëpunuar rrjedhshëm me departamente të tjera.

Falenderojmë Will Boricin për përkthimin në shqip të këtij manifesti.

SPECIALISTË TË TË DHËNAVE:

Jini pararendës në lidhje me komunikimin me specialistë të tjerë joteknikë të organizatës tuaj. Edukujini mbi konceptet e të dhënave. Bëhuni këshillues mbi të dhënat dhe ndihmoni të tjerët të kenë sukses.

FILLONI NGA PUNA

Jetojmë në kohë stimuluese dhe sfiduese. Stimuluese, sepse të dhënat ofrojnë mundësi për të krijuar avantazhe konkurruese, për të përmirësuar produktet dhe shërbimet aktuale (dhe për të krijuar të tjerë), për të kuptuar më mirë klientët tuaj dhe për të ulur kostot. Sfiduese, sepse të riparosh çka është prishur është e mundimshme dhe ata që vonojnë mund të përfundojnë në disavantazh të madh.

Mbani parasysh këtë manifest.


**SHPËRNDAJENI.
DEBATOJENI.**

Dhe vëreni në punë në organizatën tuaj.



JOHN LADLEY
[TWITTER.COM/JLADLEY](https://twitter.com/JLADLEY)

Author, *Making EIM Work for Business and Data Governance: How to Design, Deploy and Sustain an Effective Data Governance Program*



DANETTE MCGILVRAY
[TWITTER.COM/DANETTE_MCG](https://twitter.com/DANETTE_MCG)

Author, *Executing Data Quality Projects: Ten Steps to Quality Data and Trusted Information™*



KELLE O'NEAL
[TWITTER.COM/KELLEZONEAL](https://twitter.com/KELLEZONEAL)

Author, *Turning Data Into Insights* series for CIO.com



JAMES PRICE
[TWITTER.COM/RETHINKINFO](https://twitter.com/RETHINKINFO)

Author, *Barriers to the Effective Deployment of Information Assets: An Executive Management Perspective*



TOM REDMAN
[TWITTER.COM/THEDATADOC1](https://twitter.com/THEDATADOC1)

Author, *Getting in Front of Data and Data Driven: Profiting from Your Most Important Business Asset*